



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale
Mbledhja nr. 59
Prishtinë, më 16 mars 2010, në orën 13: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Komisionit të Shëndetësisë, të Punës
dhe të Mirëqenies Sociale**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Qamile Morina, Flora Brovina, Vezira Emrush, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Rrezarta Ahmeti – KDI , Lejla Selimi – OSBE dhe Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 16. 02. 2010 dhe 03. 03. 2010 ;**
- 3. Raportimi i grupeve punuese për projektligjet në procedurë,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 16. 02. 2010 dhe 03. 03. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16 shkurt 2010, me vërejtjen teknike të deputetes Gjylnaze Sylja.

3. Raportimi i grupeve punuese për projektligjet në procedurë

Sadik Idriz – Janë të formuara tri grupe pune që i shqyrtojnë dhe bëjnë propozime për amendamentimin e tri projektligjeve, të cilat janë në procedurë. Fillimisht Rita Hajzeraj, si kryesuese, do të na njoftoj për punën e grupit punues që e ka në shqyrtim Projektligjin për produkte dhe pajisje medicinale.

Rita Hajzeraj - Projektligji për produkte dhe pajisje medicinale është një projektligj i rëndësishëm dhe duhet punuar shumë në mënyrë që ai të jetë sa më i mirë. Grupi punues ka mbajtur një takim dhe ka shqyrtuar edhe propozimet e dhëna në dëgjimin publik. Në dëgjim publik ka pasur mjaft propozime, kështu që grupi punues ka vendosur të ketë edhe një takim në këtë javë me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, të AKPM, të SHFK- së. Në këtë takim edhe një herë do të diskutohen dhe do të sqarohen disa propozime për ndryshimin e Projektligjit. Shumë është diskutuar për pavarësinë e AKPM- së. Kam pasur disa konsultime me ekspertë dhe është e qartë që përmes këtij projektligji nuk mund të ndërrohet statusi i AKPM -së, por nevojitet një ligj i veçantë. Grupi punues do të vazhdojë punën dhe shumë shpejt para Komisionit do t'i paraqesim edhe propozimet konkrete për amendamentimin e Projektligjit.

Një vërejtje konkrete e kam në nenin 19, pika 3, ku në ligjin e mëhershëm ka qenë që kryeinspektori dhe inspektorët farmaceutikë mund të jenë edhe kimistë e fizikanë, ndërsa në ligjin e ri janë hequr. Sipas standardeve të BE - së, inspektorët farmaceutikë duhet të kenë përgatitje profesionale adekuate, në pajtim me rregullat dhe direktivat e BE - së. Qëndrimi im është që në Projektligj të përfshihet edhe kjo kategori.

Teuta Hadri – Ne kemi pasur një ligj në fuqi, por ligji ka pasur nevojë për ndryshime dhe kishte propozime për ndryshime. Duhet të përfshihen të gjitha propozimet e të ftuarve në dëgjim publik.

Flora Brovina – Të gjitha propozimet e të ftuarve në dëgjimi publik të kthehen në amendamente nga grupi punues, pastaj t'i diskutojmë në Komision.

Gjylnaze Syla – Nuk mendoj se ky projektligj ka një koncept të ri në krahasim me ligjin e vjetër. Ministria është dashur ta sjellë plotësimin dhe ndryshimin e ligjit, e jo ligj të ri.

Qamile Morina – Ligji nuk ka pësuar shumë ndryshim. Ne duhet të angazhojmë një ekspert, i cili do ta na ndihmonte në punën tonë. Duhet t'i marrim parasysh propozimet e grupeve të interesit, por duhet ta qartësojmë se a duam ta bëjmë një ligj në pajtim me rregullat dhe direktivat e BE - së, ose një ligj, në të cilin do të përfshihen propozimet e grupeve të interesit. Gjithashtu duhet sqaruar përse në ligj nuk janë përfshirë produktet veterinare. Ligji i vjetër i ka përfshirë edhe produktet veterinare, tani nuk e di përse është hequr kjo pjesë.

Sadik Idriz – Sa i përket dilemës se a duhet të jetë plotësim dhe ndryshim i ligjit apo ligj i ri, Kuvendi e ka votuar si ligj të ri, tani ne duhet vetëm të punojmë në amendamentim.

Flora Brovina – Edhe grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për kryqin e kuq ka mbajtur një takim. Në atë takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, zyra në Kosovë. Grupi punues nga të ftuarit ka marrë propozimet konkrete dhe do të vazhdojë punën në amendamentimin e Projektligjit.

Sadik Idriz - Edhe grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, ka mbajtur një takim me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe

përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, zyra në Kosovë. Grupi punues ka shqyrtuar disa propozime të seancës plenare dhe të deputetit Riza Smaka, si dhe propozimin e Ferid Aganit, që Ligji i kryqit të kuq të quhet, Ligji për kryqin e kuq dhe gjysmëhënën e kuqe. Nga të ftuarit u njoftuar se ka një problem që konventat ndërkombëtare nuk lejojnë që asnjë organizatë nacionale e Kryqit të Kuq të ketë dy emra - edhe të gjysmëhënës së kuqe. Kjo i lejohe vetëm konfederatës, organizatat nacionale mund të quhen ose Organizata e Kryqit të Kuq ose e Gjysmëhënës së Kuqe. Grupi punues do të vazhdoj punën dhe shumë shpejt para Komisionit do t'i paraqesë edhe propozimet për amendamentim.

Rita Hajzeraj – Pajtohem që të jetë vetëm një Ligj edhe për Kryqin e Kuq edhe për Gjysmëhënën e Kuqe. Por pasi kjo tash për tash është e pamundur, të shpresojmë që në të ardhmen do të krijohen rrethanat që të mund të kemi edhe një Ligj për gjysmëhënën e kuqe.

Flora Brovina – Asnjë organizatë nacionale e kryqit të kuq nuk mund të ketë dy tituj. Këtë të drejtë e ka të rezervuar vetëm Organizata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe e Gjysmëhënës së Kuqe. Kushtetuta e Kosovës e përcakton se Kosova është shtet laik dhe se të gjitha fetë janë të barabarta, prandaj Organizata e Kryqit të Kuq është organizatë humanitare. Kryqi i Kuq i Kosovës ka vepruar me vite të tëra me këtë emër dhe kjo është vetëm një vazhdimësi.

Gjylnaze Syla- Qëllimi kryesor i këtij ligji është arritja e Organizatës së Kryqit të Kuq të Kosovës që të anëtarësohet në Organizatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, që deri me tani nuk ka arritur të anëtarësohet në mungesë të ligjit. Gjithashtu edhe tradita e Kosovës është se ka ekzistuar edhe më herët Kryqi i Kuq i Kosovës. Futja në Organizatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq të Kosovës automatikisht e bën të pranueshme edhe Gjysmëhënën e Kuqe. Sa i përket Ligjit për emblemën e kryqit të kuq ndoshta mund të jenë në një ligj të përbashkët.

Sadik Iriz – Grupet punuese do të vazhdojnë punën. Pas përfundimit të propozimeve për amendamente Komisioni do të shqyrtojë dhe do të miratojë amendamentet e propozuara. Projektligji për kryqin e kuq dhe Projektligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, shumë shpejt do të përfundohen, ndërsa Projektligji për produkte dhe pajisje medicinale kërkon më tepër kohë.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – Për këtë pikë kemi një prezantim të projekteve për përkrahje Komisionit nga zyrtarja e UNDP, zonja Nora Sahatçiu.

Nora Sahatçiu – UNDP - ja, do të vazhdojë me përkrahjen e këtij Komisioni. Ndhimja e UNDP - së do të vazhdojë në ato çështje që i kemi filluar më herët. Do të punojmë bashkërisht në disa ligje shumë të rëndësishme për shëndetësinë në Kosovë. Për t'ju ndihmuar në punët tuaja UNDP - ja, ju prezanton edhe dr. Lulzim Çelën, i cili si ekspert do të ju përkrah në punën tuaj.

Lulzim Çela – Përvoja ime si mjek është për 12 vjet në shëndetësinë e Kosovës, pastaj në organizata ndërkombëtare, një vit e gjysmë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe tani si konsulent i pavarur. Kjo është një përvojë imja në sistemin shëndetësor, e sidomos interesimi im ishte për politikën shëndetësore. Kosova është në një udhëkryq të madh të reformimit të sistemit shëndetësor dhe Komisioni i juaj do të jetë i ballafaquar me disa ligje bazë të reformimit të sistemit shëndetësor. Në këtë aspekt unë, për aq sa di, do të jem i gatshëm për të ju ndihmuar në gjitha sferat e kësaj fushe.

Nurishahe Hulaj – Ne kemi nevojë për një përkrahje më shumë profesionale se sa ligjore. Në shëndetësi e kemi një pako të ligjeve që e kanë bërthamën e vet, por të cilat nuk po konkretizohen. Këto ligje nuk po konkretizohen, sepse nuk kanë mbulesë financiare. Nuk mund të ketë reformë shëndetësore pa e pasur Ligjin për sigurime shëndetësore, Ligjin e punës dhe Ligjin e shëndetësisë me plotësimin dhe ndryshimin e propozuar. Ne duhet të bëjmë përpjekje që këto ligje t'i konkretizojmë dhe ta realizojmë edhe planin tonë. Në këtë aspekt presim përkrahjen edhe të UNDP - së.

Qamile Morina – Mendoj se edhe mjetet financiare janë pengës, por pengesa më e madhe në mos fuqizimin e këtyre ligjeve të rëndësishme është mungesa e vullnetit politik.

Veziira Emrush – Kur janë në pyetje këto ligje bazike, ne duhet të krijojmë një plan të punës, në të cilin do të përfshihen ligjet bazike dhe i cili plan do t'i prezantohet Qeverisë dhe të kërkohet që Qeveria t'i procedojë ato ligje sa më parë në Kuvend.

Teuta Hadri – Ne disa herë kemi kërkuar nga ministrat që ligjet bazike të procedohen sa më shpejt në Kuvend. Edhe plani i punës është miratuar sipas strategjisë legjislative. Tani vetëm presim që ato ligje, sipas dinamikës së paraparë të arrijnë në Kuvend.

Qamile Morina – Ne, në Kuvend, kemi miratuar një rekomandim për financimin e vaksinave, dokument i cili nuk ka ardhur në Komisionin tonë. Programi për vaksinimin kombëtar ka ndryshuar nga ai që ne e kemi në dokumentet tona. Më shqetësuese është se ka hyrë një vaksinë e re, e cila e ndërton programin e vaksinimit të popullatës. Propozoj t'i ftoj më përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe të na njoftojnë përse është bërë ndryshimi i programit kombëtar të vaksinimit, në krahasim me atë program që e ka paraqitur Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Kam rezerva për hyrjen e pentallaksit në Kosovë, i cili nuk është i licencuar nga Agjencia evropiane dhe nuk përdoret në Evropë. Kam biseduar edhe me përfaqësues të UNICEF - it në Kosovë, të cilët nuk marrin përgjegjësi për llojet e vaksinave dhe efektet e tyre, por vetëm kontraktajnë blerjen e tyre sipas kërkesës së institucioneve të Kosovës..

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, u vendos që në mbledhjen e radhës të ftohet kryesuesi i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, që të paraqesë para Komisionit informatë për programin kombëtar të imunitetit të detyruar të popullatës për vitin 2010.

Qamile Morina – Propozoj që këtë vit Komisioni ta bëjë një vizitë në spitalin e pjesës veriore të Mitrovicës.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz